



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
REKTORATI

Nr. 1974 / Prot.
3

Vlorë, më, 14.12.2021

VENDIM

Nr. 30, datë 13 . 12. 2022

Për

MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË PROJEKTEVE TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË.

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të vendimit të Rektoratit, Nr. 10, datë 30. 06. 2022 për “Miratimin e projekt propozimeve të njëjësive kryesore dhe njëjësive bazë në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë”, të shkresave të Dekanes së Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë, Nr 583/1 Prot., Nr. 583/2 Prot, dhe Nr. 602 Prot, datë 02.12.2022 Rektorati, në mbledhjen e zhvilluar në datën 13. 12. 2022,

VENDOSI

1. Të miratojë raportin përfundimtar të projektit “Gjendje, dukuri, tipare, tipologji të bashkësive të pritjes (të audiencës) nën ndikimin komunikativ të masmedias në qarkun e Vlorës: vërejtje e përcaktime në shërbim të programeve akademike, të publikut dhe të ndërmarrjeve në fushën e medias, koordinator Dr. Ermir Xhindi, Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë
2. Të miratojë raportin përfundimtar të projektit “Onomastika krahasuese si aftësi krijuese e bashkësisë iliro-shqiptare, vlerë dokumentare e ligjërimit të trashëguar”, koordinator Prof. Dr. Nexhip Mërkuri, Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë “
3. Bashkëlidhur raporti përfundimtar i punës së kryer në kuadër të realizimit të këtyre dy projekteve të Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë, Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori i UV-së dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Roland ZISI

